

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje elektronike matëse dhe detektorë”;

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38420000-5;

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,932,878 (pesë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40 % të fondit limit të kontrates.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm

nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

## **2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

*2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, dhe nenit 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një "kompetencë thelbësore", ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

*2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente me të).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në nenin 44 "Kërkesat e Cilësisë" të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën objekt prokurimi pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendorsja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

*2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skeda teknike/data sheet/katalogun e prodhuesit ose fragmente të katalogut për mallin që prokurohet, ku të pasqyrohet dhe të specifikohet qartë vegla me specifikimet teknike që ofrohen me specifikimet teknike e kërkuara ne DT. Fragmentet e katalogut duhet të tregojnë qartë që janë pjesë e katalogut. Të dhënat teknike, të pakten ato të kërkuara ne specifikimet teknike duhet të jenë në gjuhën shqipe (te përkthyer dhe noterizuar).*

*2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një tabelë sipas modelit të bashkelidhur DT, ku të pasqyrohet minimumi i të dhënave si më poshte:*

- *Numrin e zerit të artikullit të kerkuar nga Autoriteti Kontraktues*
- *Pershkrimin e artikullit të kerkuar nga Autoriteti Kontraktues*
- *Sasine e artikullit*
- *Marken e artikullit të propozuar nga Operatoret Ekonomik*
- *Modelin/Numrine e pjeses për artikullin e propozuar nga Operatoret ekonomik*
- *Linkun (e klikueshem) i cili të dergon tek katalogu online (faqe zyretare) apo skeda teknike zyretare(zyrtare) për artikullit që propozohet nga operatori ekonomik*
- *Standardi i artikullit të propozuar*

*Informacioni i pasqyruar në tabelë do të përdoret si për të vlerësuar konformitetin dhe përputhshmerine me specifikimet teknike të DT, ashtu edhe për të vlerësuar kapacitetin teknik të operatorit ekonomik (sipas ISO 9001).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara specifikimet teknike, AK ka të drejtë të kërkojë edhe paraqitjen e katalogeve ose fragmenteve të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të jenë të kuptueshme nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave. Kjo kërkesë në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit, si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. AGS sha duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij që të kërkojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë origjinalitetin e produkteve të furnizuara.

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurrohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut te lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose te tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara ne Kodin e Etikes të AGS SHA qe kane lidhje me realizimin e objektit te kësaj kontrate.

### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Klientit tone TAP dhe Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt prokurimi, natyrën e tyre specifike, afatin kohor për realizimin e këtij furnizimi, si dhe bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*